


Angazhohu Monitoro Vepra



SUPLEMENT I GAZETËS NOSITI NGA GRUPI MONITORUES I TË RINJVE
POGRADEC, KORRIK 2015 ÇMIMI 20 LEKË

T'i imponohemi Pushtetit Vendor me intonacionin rinor!



MONITORIMI I
KËSHILLIT
BASHKIAK,
POGRADEC
DOSJA NR. 13

Ç'PO NDODH?!	faqe 2
RINGJALLJA E SPORTIT POGRADECAR	faqe 3
INTEGRIMI I PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA NË SHOQËRI	faqe 4
FËMIJËT JANË NJË DHURATË	faqe 4
NJË LIDERSHIP I NDJESHËM NË ÇËSHTJET SOCIALE	faqe 5
KONCEPTI MBI VETEN	faqe 5
NDËRGJEGJËSIMI I TË RINJVE PËR SST	faqe 6
RËNDËSIA E TERAPISË FIZIKE	faqe 6
PLANIFIKIMI I KARRIERËS	faqe 7
INTERVISTA	faqe 8

ZGJIDHNI QUITZ NË FQ. 2 DHE MERRNI NJË DHURATË NGA GRUPI MONITORUES

Ne ishim vullnetarët e parë pranë shoqatës “Unë, Gruaja”. U rritëm së bashku dhe u bëmë lidera.

Sot ne jemi trajnerët e projektit: “Më shumë të rinj në Leadership nëpërmjet pjesëmarrjes qytetare”.

Shumë të rinj pogradecarë i janë bashkuar nismës sonë, për të qenë të suksesshëm në jetë, për të marrë përgjegjësi dhe sfida qytetare. Ata nesër do të jenë liderat e së ardhmes.



Na ndiqni në FB, shoqata “Unë, Gruaja” (Bëni “Like”), Pogradec. Tel. 08322 2140

Ç'po ndodh?!



Në fakt është një pyetje që të gjithë e bluajmë në mendje, një pyetje që ia bëjmë të gjithëve dhe vetes po ashtu. Është pyetja që po na lodh e po na dërrmon, megjithëse përgjigjen e dimë të gjithë. E kuptojmë të gjithë se përse është kjo gjendje, përse asgjë nuk po rregullohet, përse qeveritë ikin e vijnë e askush nuk merr përgjegjësitë ta rregullojë këtë gjendje. Askush nuk dënohet e askush nuk qortohet që bën çfarë të dojë e abuzon sa të dojë.

E pra ç'po ndodh!? Pse po ikin kaq shumë shqipëtarët? Pse po ikin kaq shumë të rinjtë? Pse askush nuk ka besim tek qeveritarët dhe te e ardhmja këtu? Rreth 75% e të rinjve shqiptarë duan të ikin jashtë qoftë për të studiuar apo për të jetuar dhe kjo është shumë në fakt.

Ajka e popullsisë nuk dëshiron të jetojë këtu nuk e shikon dot të ardhmen këtu, janë kaq të pashpresë këtu, e shohin veten kaq pa të ardhme si ata të arsimuarit dhe atë të pa arsimuarit, si ata të fshatit dhe ata të qytetit, si zanatxhinjtë dhe ata që nuk dinë ç'është puna, si ata që punojnë dhe ata që janë të papunë.

Po pse!? ç'po ndodh!? Sepse ky vend çdo ditë po bëhet gjithnjë e më tepër i pajetueshëm, i ashpër dhe i padrejtë, sepse këtu i varfëri diskriminohet dhe i pasuri jo, sepse këtu i pasuri punësohet pamvarsisht aftësisë dhe i varfëri jo. Sepse këtu i pasuri merr shërbime ndërsa i varfëri jo, sepse i pasuri pasurohet dhe i varfëri varfërohet. I pasuri është i destinuar të jetë mja

e piramidës ndërsa i varfëri vazhdimisht diskriminohet dhe vazhdimisht poshtërohet.

Kjo po ndodh këtu tek ne, kjo po ndodh në Shqipëri. Jemi të pozicionuar në zemër të Europës dhe urë lidhëse e Europës me Ballkanin, kemi dete, dy madje, Adriatik dhe Jon, kemi liqene të tillë si: Prespa, liqeni i Shkodrës, i Pogradecit, etj.

Kemi lumenj kaq shumë. Kemi naftë shumë më tepër nga sa ne dimë dhe mund të imagjinojmë, kemi qymyr dhe hekur nikel ndër më të pasurit në Europë, kemi rezerva drusore dhe mrekulli natyrore e arkitekturore të jashtëzakonshme. Kemi gjithçka, por nuk kemi asgjë. Kemi shumë, por në tavolina kemi kaq pak. Duhet të jetojnë kaq mirë, por që jetojnë nën minimumin jetik. 400.000 shqiptarë që jetojnë vetëm me më pak se gjysëm \$ në ditë.

Po çfarë mund të bëj dikush me gjysëm \$ në ditë, çfarë mund të bëjë një familje me kaq pak? Si mund ta ndiejë veten një fëmijë, një adoleshent me kaq pak për të jetuar. Si mund ta ndiejë veten një baba, një prind me kaq pak?! Si mund të ndihet një gjysh që ka punuar gjithë jetën dhe tek e fundit duhet të shijojë të vërtetën e hidhur, duke parë fëmijët dhe nipërit e vet të vuajnë dhe të diskriminohen, të enden rrugëve dhe mos gjejnë një vend pune.

Kjo po ndodh me ne. Shqipëtarët kanë vite që po ikin, por kjo është një hemoragji që askush minimalisht nuk po tenton ta ndalë. Tre eksode pas demokracisë kanë pasur shqiptarët i pari në '92, i dyti në '97, dhe së fundmi tani, në 2015 kur shqiptarët janë anëtarë të NATOS dhe kanë statusin e kandidatit për në BE, por të gjithë po ikin me mënyra nga më të ndryshme. 25 vite demokraci dhe askush nuk ka arritur ta ndalojë këtë gjendje, askush nuk e ka rregulluar këtë gjendje.

Këtu askush nuk shpreson më, nuk shpreson se Shqipëria do bëhet. As unë vetë, madje. Jemi një shoqëri pesimiste dhe pesimizmi na ka kapur për "fyti". Nuk besojmë tek klasa jonë politike, nuk besojmë më tek drejtuesit tanë pasi i kanë dhënë faktet se përse nuk duhen besuar.

Të jetosh në zemër të Europës ku puna është luks, jo domosdoshmëri e jetesës. Ku i varfëri përbuzet dhe quhet dështak e i paaftë. Jemi një shoqëri me probleme për shumë arsye. Sepse drejtohem nga njerëz me probleme e ku drejtojnë ata që korruptohen, ata që vrasin e ata që shtypin. 35% e popullsisë ka emigruar, tendencë, e cila është në rritje. Ku ekonomia rritet me përqindje qesharake, ku çdo shqiptar që lind ka 3000 \$ borxh në bankat e Europës. Çdo ditë e më tepër vendi ynë po shpopullohet.

Të rinj e në moshë po marrin arratinë e po ikin. Po dynden dyerve të Europës pa i ftuar kurrkush dhe pa i pritur askush!. Po ç'po ndodh pra?! Pse po ikin? Po lënë gjithçka kanë ndërtuar në 25-të vite demokraci, po largohen, po largohen nga pronat e tyre, nga vendi, nga miqtë dhe nga shokët, vetëm të mos jetojnë si prindërit e tyre dhe fëmijët të mos vuajnë siç ata kanë vuajtur.

Shqipëria po braktiset dhe ky është një fakt i hidhur, pasuritë po zhvlerësohen dita ditës, bizneset po falimentojnë dhe kjo, sigurisht që sjell pasoja akoma më të mëdha. Tendenca e emigrimit të të rinjve, e cila po e zvogëlon Shqipërinë dita-ditës, ka pasoja që do t'i vuajë kushdo, edhe ata që kanë zgjedhur ta jetojnë jetën këtu. Bizneset do të falimentojnë, pasuritë e patundshme do zhvlerësohen dhe investitorët nuk do të vijnë. Nuk do të vijë askush në një vend që coptohet dita-ditës, nuk do të zgjedhë askush të investojë në një vend ku të gjithë po tentojnë të largohen.

Po merr dikush masa? JO, ASKUSH, përpiqen t'i ndalojnë forcërisht. Ja pra kjo është kundërpërgjigjia që qeveria shqiptare i jep këtij fenomeni "t'i ndalojë forcërisht", gjë e cila në fakt ngjan si diktaturë, si "një tjetër Kore" në mes të Europës.


Ja pra ç'po ndodh... "Qeverisemi shumë keq, kemi patur diktaturë dhe në demokraci, vazhdojmë të jetojmë këtë tranzicion që ngjan i pafund, drejtohem nga njerëz që dashurojnë pushtetin dhe jo shtetin. Kemi nevojë për "dikë" a "diçka", në të kundërt ky do jetë fundi ynë...

Punoi: Eduart Hyka

QUITZ informues

- Si quhet ministri përgjegjës për implementimin e reformës administrative-territoriale?
- Cili është numri i qarqeve që do të funksionojnë pas reformës/zgjedhjeve lokale?
- Cili është numri i bashkive që do të funksionojnë pas reformës/zgjedhjeve lokale?
- Kur nis nga puna Këshilli i Bashkisë, pas zgjedhjeve lokale?
- Sa do të jetë numri i këshilltarëve në Këshillin Bashkiak të Pogradecit?
- Sa prej kompetencave apo funksioneve të pushtetit vendor do të ndryshojnë dhe cilat janë ato?
- Si do të realizohet decentralizimi i pushtetit (kompetencave) pas implementimit të reformës/zgjedhjeve lokale?
- Si do të realizohet korrespondenca zyrtare ndërmjet njësive të qeverisjes vendore, sipas secilës shkallë të pushtetit vendor?

Përgjigjet e sakta dërgojini me email: une_gruaja@yahoo.com, ose FB: shoqata Une, Gruaja. Fituesi shpërblehet me...



Ringjallja e sportit pogradecar

Jetojmë në një qytet, të cilit natyra i ka falur bukuri përrallore. Aty ku çdokush mund të gjejë paqe shpirtërore. Qytet krijues, i cili ka nxjerrë shkrimtarë të famshëm në literaturën shqiptare. Vend me njerëz të cilët i karakterizon fryma lasgushiane në çdo shprehje të tyre.

Bukuri natyrore e kulturore pafund!!!!

Por nuk janë vetëm këto që e bëjnë qytetin tonë atraktiv. Pogradeci i ka pasur të gjitha mundësitë për të shfrytëzuar të gjitha llojet e sporteve, dhe kjo për vetë pozicionin e tij gjeografik.

Në këtë shkrim do flas për sportin e volejbollit për të cilin unë si volejbolliste kam afeksion të veçantë.

Rreth viteve '90 një grup vajzash të reja ngrejnë në këmbë sërish volejbollin Pogradecar. Këtu spikati: Matilda Niça, Denisa Maçolli, Olina Mato, Elona Berberi. Në krye të tyre u vu profesor Llazi Kërzhalli, trainer me mjaft ambicje, i palodhur kurrë në punën e tij me dëshirën e tij të pafund për të mos lënë këtë sport të vdiste. Ai krijoi në 1999 një ekip të ri, që futet direkt në kategorinë e parë, me emrin "RINGJALLJA", duke sinjifikuar ringjalljen e këtij sporti në qytetin tonë.

Me këtë ekip arriti rezultate shumë të mira pavarësisht kushteve të vështira. Spikatën: Denisa Kllogjëri, Poliana Ambo, Dorina Hoxhalli, Anjeza Isaku etj duke u cilësuar një brez me arritje të mëdha...

U arritën këto rezultate: -2000, Kampion Kombëtar, të rritura, -

2002, nënkampion kombëtar të reja, - 2003, kupa "Ela Tase", të reja, -2003, kampion kombëtar, të reja.

Në sezonin sportiv 2004-2005 kanë luajtur në A2 duke mundur "Partizanin", 4 herë, "Krutjen" 1 herë.

Nga dashuria e madhe për këtë sport prof. Llazi sjell për herë të parë në Shqipëri sportin e plazhit Beach-Volleyball. Eshtë zhvilluar kampionati i I-rë ballkanik i këtij sporti për të Reja dhe të Rritura në Korrik 2004.

Në këtë sport vajzat Denisa Maçolli dhe Olina Mato, janë shpallur për dy vjet rresht kampione të vendit (1995-1996).

Ky ishte një sukses për trainerin, për vajzat dhe sigurisht për qytetin. Duke parë aftësinë e këtyre vajzave federata i cakton të përfaqësojnë Shqipërinë në Kampionatin European në Gjermani, po ashtu edhe në Lituanë, por fatkeqësisht për mungesë fondesh nuk morën pjesë në asnjërin prej tyre.

Tradita u vazhdu nga vajzat e ekipit "RINGJALLJA" duke arritur këto rezultate: 6 herë kampione, 5 herë nënkampione në Shqipëri.

Janë shpallur nënkampione Ballkani në vitin 2004 në Pogradec (të reja). Në 27 Dhjetor 2007 ekipi del nënkampion me para të rejtat.

Pogradeci ka pasur arritje në të gjitha sportet. U ndala pak më tepër tek sportet e lojërave me dorë, sepse ato janë sportet që



kanë arritur më shumë rezultate, por që janë harruar nga të gjithë. Kjo është problematika që unë dua të përcjell tek ju bashkëqytetarët e mij. Më vjen keq të them që sot këto sporte kanë humbur. Askush nuk e ndihmon sportin e lojërave me dorë. Nuk mjafton vetëm vullneti dhe dëshira e mirë e pak trainerëve të cilët e bëjnë këtë punë vullnetarisht.

Por ku po shkon kjo rini???

Kthejini sytë nga ata dhe mos rritni vetëm duke i gjykuar se pse ata janë dashuruar pas botës së teknologjisë dhe asaj virtuale. Ndihmohuni për t'iu kthyer atyre dëshirën për sportin. Për një shëndet si fizik ashtu edhe psikologjik sa më të mirë.

Nuk e mirëkuptoj aspak neglizhencën që është treguar ndaj këtyre sporteve, por e dëshiroj shumë një reagim pozitiv, për të ndihmuar këtë rini, për ta gjallëruar ashtu si më parë këtë qytet që mbart në vetvete shumë talente.

Shumë prej jush mund të thonë: "Kemi shumë probleme të tjera për të menduar e për të zgjidhur".

Dëshiroj t'ju them të mendoni për rininë, fëmijët, nipërinjtë tuaj. Prindër të rritim të gjithë së bashku një rini të shëndetshme, me frymë pozitive e miqësore. Mos u justifikoni duke thënë se sporti të lodh dhe të lë pas me mësimet. JO! Përkundrazi truri juaj do të jetë më i freskët, kjo është vërtetuar shkencërisht. Të gjithë duhet të nxisim reagimet tek ata të cilët kanë kompetenca për të investuar e ndihmuar.

Ne duhet të japim kontributin tonë në ringjalljen e sportit pogradecar.

*Zgjuhuni qytetarë pogradecarë,
T'iu themi faleminderit atyre,
Që na i trashëguan këto sporte,
Dhe t'i bëjmë të ndihen krenarë!!*


Mos lejojmë që Pogradeci të humbasë këto tradita të vlefshme!

Ta bëjmë Pogradecin, këtë perle të Ballkanit, atraktiv në çdo aspekt!

Punoi: Ozvelta Laze



Integrimi i personave me nevoja të veçanta në shoqëri



Çdonjërit prej nesh mund t'i ndodhë që në lagje, në fis, apo edhe në familje mund të ketë një person me nevoja të veçanta. Ndoshta kemi ndaluar për një moment reflektimi duke i bërë pyetjen vetes, a po jap edhe unë një kontribut sado të vogël në jetën e këtyre personave?

Unë jam Punonjëse Sociale në një Qendër Jo Fitimprurëse në Pogradec, e cila quhet Drita e Shpresës dhe operon në drejtimin e përmirësimit të jetesës së personave me nevoja të veçanta në disa drejtime.

Projekti i "Ateliesë Kreative", ku unë personalisht punoj, iu ofron personave me



nevoja të veçanta mundësinë për të zbuluar talentet e tyre dhe për t'u aktivizuar nëpërmjet ergoterapisë në punime të ndryshme artizanale. Kjo lloj mënyre terapeutike i ndihmon ata, jo vetëm për përmirësimin e lëvizjeve motorike, por nxit edhe aftësitë konjitive. Gjithashtu puna në grup i ndihmon në zhvillimin e marrëdhënieve ndërpersonale.

Punimet në të cilat ata aktivizohen janë kryesisht: krijimi i pikturave prej druri, guri, letre, thurje kanistrash, endje rrugicash për vajzat, etj. Gjithësecili zgjedh "punën" e tij të preferuar dhe përpiqet të japë maksimumin. Përfundimi është një punim, për të cilin ai/ajo është shumë krenar/e! Sa gëzim dhe vlerësim i madh është për ata të shikojnë njerëz të ndryshëm që pëlqejnë produktet e prodhuara nga vet ata me shumë dashuri. Këtu do të doja të citoja një thënie të Nënë Terezës: "Nuk ka rëndësi se çfarë bëjmë, por sa dashuri vendosim në atë që bëjmë". Në këtë drejtim ne si shoqëri duhet të mësojmë prej tyre, të cilët në çdo punim të bërë nga duart e tyre i karakterizon buzëqeshja dhe dashuria.

Të shikosh ata që me gjithë vështirësitë fizike apo mendore që kanë, përsëri janë aq të motivuar dhe kanë shumë dëshirë dhe gëzim për të krijuar diçka me duart e tyre, prekem aq shumë në zemër sa mendoj: çfarë mund të bëj më shumë për ata?

Lexues i dashur!

Ti që po lexon këtë artikull, edhe ti mund të bësh diçka për këta njerëz. Do të doja të hedhësh një hap dhe të japësh kontributin tënd duke iu dhënë një dorë dhe duke qenë ti pjesë



e integritit të tyre në shoqëri. Mënyrat se si mund ta bësh këtë janë të ndryshme dhe të lehta. Dëshira dhe guximi varen vetëm nga ti.

Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtij artikulli, që shpresoj të ketë një ndikim sado të vogël, për të marrë një hap në mbështetjen e këtyre personave.

Ne jemi të gatshëm për një bashkëpunim me secilin prej jush që është i gatshëm të bëjë diçka. Ndoshta ke ide të vyera, ndoshta ke mundësi të ndryshme për të ndihmuar, ndoshta ke dëshirë thjesht të vish dhe të marrësh pak nga koha jote me ta duke pirë një kafe së bashku dhe duke treguar vlerësimin tënd. Për ata do të kishte një domethënie të madhe dhe do të mbetej në kujtime.


Me shumë dëshirë do të lemë edhe kontaktet tona në këtë faqe dhe së bashku mund të bëjmë shumë, më shumë për ata.

Vasilika Hidri Rapçe

Punonjëse Sociale, Qendra Drita e Shpresës

Tel:083 22 6941, drita@drita-al.org.

Fëmijët janë një dhuratë



Në Shqipëri mund t'i shikoni fëmijët kudo. Ata luajnë në oborr, në plazh apo në rrugë. Fëmijët shkojnë në shkollë, vijnë me (sjellin) shokët ose të afërmit në shtëpi, etj. Por fëmijët me aftësi të kufizuara janë shumë rrallë në rrugë. Pse?

Patjetër Shqipëria ka fëmije me aftësi të kufizuara, por është e vështirë t'i shikosh ata. Shumica nga ata janë fatkeqësisht -çdo ditë në

shtëpi. Por këta fëmijë kanë nevojë për shokë me të cilët ata mund të luajnë dhe lëvizin në ajër të freskët për një zhvillim më të mirë. Gjithashtu këta fëmijë kanë nevojë për dashuri, lavdërim, njohje dhe vlerësim (si çdo fëmijë tjetër), nga prindërit e tyre në radhë të parë. Prindërit janë personat e parë më të rëndësishëm për fëmijët e tyre, të cilët i formojnë dhe i përgatisin ata për jetën.

Ka shumë prindër, të cilët dëshirojnë një fëmijë por për momentin nuk e kanë. Në veçanti këta prindër thonë, se çfarë dhurate është të kesh një fëmijë. Shumica e prindërve gjithashtu i shikojnë fëmijët e tyre si dhuratën më të bukur.

Por shumë prindër me fëmijë me aftësi të kufizuara nuk e shikojnë këtë dhuratë të çmuar tek fëmija i tyre, por vetëm problemin. Ata thonë, se nuk e kishin përfytyruar, se do të ishte

kaq e vështirë me një fëmijë me aftësi të kufizuara. Natyrisht që është e vështirë, por askush nuk thotë që jeta është e lehtë. Jeta është plot me surpriza dhe rrallë është si ju e keni dëshiruar ose planifikuar. Ajo është gjithashtu e vështirë dhe me një fëmijë të shëndetshëm, nëse ai nuk sillet si duhet ose ai ka ndjekur një rrugë që nuk është e mirë.

Prandaj le të guxojmë dhe të gëzohemi për çdo fëmijë që është në botë.

Përmes fëmijëve jeta ndryshon shumë. Fëmijët e shikojnë botën ndryshe nga të rriturit. Ata p.sh. i japin një luleje kaq shumë vëmendje, ndërkohë që të rriturit thjesht e anash kalojnë.

Ata e shikojnë botën me sytë e tyre dhe i kushtojnë kohë gjërave të cilat për ne duken si pa kuptim, por që e pasurojnë jetën tonë. Veçanërisht fëmijët me aftësi të kufizuara shpesh kanë një gëzim të tillë për jetën që e transmetojnë bukur tek të tjerët.

Shkroi: Johannes Kalb

Një leadership i ndjeshëm në çështjet sociale

Gjithçka ka nisur nga një bisedë e lirë me Ermald Mekon, psikolog në profesion dhe trajner pranë shoqatës “Unë Gruaja” në projektin: Më shumë të rinj në leadership nëpërmjet pjesëmarrjes qytetare. Kemi diskutuar lidhur me trajnimet dhe përgatitjet e të qenit lider. Kjo ka qenë pikënisja, e cila na motivoi të formonim një grup, që do të trajnohej për të formuar lidera.



Jo rastësisht ka pasur specialistë dhe të diplomuar në fusha të ndryshme si infermierë, psikologë, punonjës socialë, fizioterapistë, specialist të shëndetit publik, ekonomistë, pjesëmarrës nga fusha e sportit, mësues, etj. Pas disa javësh seminar në të cilat janë referuar tema lidhur me leadershipin, dhunën në familje, dhunën me bazë gjinore, dhunën tek fëmijët, grupi jo vetëm ka nxjerrë në pah liderin, por ka marrë përsipër botimin e gazetës me

shkrime nga vetë ata. Ajo çfarë e dallon këtë grup është iniciativa e ndërmarrë për të trajtuar tema me ndjeshmëri sociale dhe të domosdoshme për realitetin dhe komunitetin për të cilin është

menduar.

Larmishmëria e grupit në profesione ka bërë të mundur realizimin e një seminari në fshatin Bishnicë, një ndër fshatrat më piktoreskë të zonës së Mokrës. Seminari ka pasur për qëllim informimin e stafit të Diakonia Albanias, veçanërisht të bashkëpunëtorëve, të cilët punojnë drejtëpërsëdrejti në qendër me fëmijët, si dhe të komunitetit i cili jeton në Bishnicë dhe të fshatrave përreth lidhur me: dhunën me bazë gjinore, dhunën në familje, format e dhunës tek fëmijët, sëmundjet seksualisht të

transmetueshme (SST), sporti dhe rëndësia e tij në jetën e përditshme. Temat janë referuar pikërisht nga grupi i liderave, të cilët kanë treguar ndjeshmëri sociale, iniciativë dhe përkushtim për banorët e fshatit Bishnicë, si dhe bashkëpunëtorët e Diakonia Albania, të cilët punojnë për të mbështetur arsimimin dhe rritjen e aftësive sociale për fëmijët e zonave të thella malore, aty ku përkujdesja nga shteti lë për të dëshiruar. Nga ana e pjesëmarrësve trajtimi i temave të tilla është parë tepër i rëndësishëm pasi ata punojnë drejtëpërsëdrejti me fëmijët, por edhe nga banorët, për përmirësimin e marrëdhënieve midis prindërve, fëmijë-prind, fëmijë-fëmijë në familje dhe komunitet.

Pas përfundimit me sukses të seminarit, pjesë e programit ka qenë edhe organizimi i aktivitetit sportiv me pjesëmarrësit në seminar, veçanërisht me të rinjtë nga Bishnicë. Grupi ka qenë tepër pozitiv, duke treguar afritet dhe përfshirje sociale. Kjo iniciativë jo vetëm na ka falur kënaqësi duke i shërbyer komunitetit, por mbi të gjitha na janë zgjuar iniciativa të tjera lidhur me çështjet sociale, së shpejti do t'i bëjmë realitet...

Msc. Manjola Lushka



Koncepti mbi veten: Kush jam unë?

Çdo gjë që bëjmë në tetëdhjetë vjet mbi anijen kozmike të globit, çdo gjë që nxjerrim si përfundim e interpretojmë, çdo gjë që fshehim e krijojmë, këdo që takojmë dhe përshëndetim, do filtrohet brenda vetes sonë. Sa dhe si e njohim veten tonë? Çfarë përcakton konceptin mbi veten tonë?

Kush jeni ju? Si krijesa unike dhe të ndërlikuar, keni shumë drejtime për të plotësuar fjalinë “Unë jam ...”. Të marra së bashku, përgjigjet tuaja, bindjet specifike nëpërmjet të cilave ju përcaktoni se cili jeni, janë vetë skemat tuaja. Skemat janë shembuj të gatshëm mendorë nëpërmjet të cilave ne organizojmë botët tona.

Vetë skemat: mënyra e përcaktimit të vetes si atlet, në mbipeshë, të zgjuar, apo çfarëdo qoftë – ndikojnë në mënyrë të fuqishme në marrjen e informacionit shoqëror. Ato ndikojnë mënyrën sesi perceptojmë, kujtojmë dhe vlerësojmë veten dhe të tjerët. Le ta konsiderojmë mënyrën sesi vetja ndikon kujtesën, një fenomen i njohur ky si efekti i vetërekordimit. Kur informacioni

është i lidhur me konceptin tonë për veten, ne e vendosim në proces shpejt dhe e kujtojmë lehtë. Nëse na kërkojnë që të krahasojmë veten me një personazh libri, ne e kujtojmë menjëherë atë personazh.

Dy ditë pas një bashkëbisedimi me dikë, ne mbajmë mend më mirë gjërat pozitive që ka thënë tjetri për ne. Kështu kujtimet tona krijojnë veten tonë. Kur mendojmë për një gjë që lidhet me veten tonë, ne e kujtojmë më mirë atë.

Kur gjykojmë paraqitjen dhe sjelljen e dikujt tjetër, shpesh në mënyrë spontane e krahasojmë me tonën.

Koncepti i vetes përfshin, jo vetëm vetëskemat tona për atë që jemi në të vërtetë, por edhe për atë që mund të jemi, vetët tona të mundshme. Hazel Markus dhe kolegët e saj vunë re se vetët tona të mundshme përfshijnë vegimet e atyre që ëndërrojmë apo të atyre që mund të bëhemi: vetja i pasur, vetja i hollë, i

dashuruari... Po ashtu përfshin: frikërat e atij që mund të bëhemi: i papunë, i sëmurë, i dështuar në akademi. Këto vetë të mundshme na motivojnë një vegim të jetës që ëndërrojmë. A është vetëpëlqimi, vlerësimi i stërmadh i vetes, përgjithësimi i gjithë vetëskemave dhe vetëve tona të mundshme, se si shohim veten: tërheqës, atletik, të zgjuar, të pasur e të dashur nga të gjithë?

Këtë mendojnë dhe psikologët kur sugjerojnë se për të ndihmuar njeriun, që të ndihet mirë me veten e tij, në fillim duhet të bëhen: tërheqës, atletikë, të zgjuar...

Xhonatan Braun argumenton se ky vëzhgim i vetëpëlqimit është i vjetëruar. Njerëzit e vlerësojnë veten në mënyrë të përgjithshme. Ata me vetëpëlqim të lartë, kanë tendencë më të madhe për të pranuar paraqitjen dhe aftësitë.

Punoi: Gerald Alillari



Ndërgjegjësimi i të rinjve për SST-të

Gjatë hulumtimeve të fundit është vënë re se disa prej nxënësve të shkollave 9- vjeçare dhe të mesme janë përdorues të duhanit, alkoolit dhe drogave të ndryshme. Nga këto të dhëna të vinte në mendje dhe marrdhëniet që mund të kishin me njëri -tjetrin dhe sa të informuar ishin ata për to. Sa i njihnin ata shkaqet e tyre dhe sa ishte e duhur në atë moshë marrja e këtij informacioni sensibilizues.



parandalimi më i mirë për të gjitha infeksionet seksualisht të transmetueshme është:

1) Në edukimin publik dhe shkollor duhet të theksohet se marrdhënia seksuale me shumë partnerë dhe përdorimi i drogës e rrisin shumë rrisun e infektimit me HIV.

2) E vetmja mënyrë për të parandaluar infeksionin është të evitohen marrdhëniet seksuale të pakontrolluara, me shumë partnerë.

3) Përdorimi i shiringave vetëm njëherë, ul mundësinë e infektimit, sidomos tek të droguarit.

4) Provat serologjike anonime duhet të ofrohen për të gjithë rastet me SST, sidomos për të droguarit dhe homoseksualët.

5) Në vendet ku HIV është i përhapur, të gjitha gratë shtatzëna testohen dhe nëse janë pozitiv trajtohen me AZT, që në fazat e para të barrës.

6) Kontrolli i donatorëve të gjakut, të organeve që transplantohen, të qelizave, të spermës, të qumshtit të gjirit, palcës së kockës etj .

7) Mjekët duhet të jenë tepër të kujdesshëm kur përcaktojnë nevojat për transfuzion gjaku apo plazme.

8) Trajtimi i faktorëve të koagulimit me nxehtësi.

9) Personeli mjekësor të përdorë doreza

Nisur nga ky fakt më lindi ideja e bërjes së një projekti për ndërgjegjësimin e të rinjve, të këtij kontigjenti (klasat e 7-ta dhe gjimnazi) për njohjen me llojet e SST-ve. Disa prej tyre janë:

- Gonorea
- Sifilizi
- Klamidja
- Vaginitis
- Lythat Genital
- HIV-AIDS
- Hepatitet

Në fund të këtij projekti u shpërndanë fletë-pallosje dhe kondom. Nxënësit u ndërgjegjësuam duke marrë informacionin e duhur për shkaqet, masat mbrojtëse dhe ku të drejtohen për bërjen e analizave etj.

Si parandalohen Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme?

Infeksione seksualisht të transmetueshme, kanë mënyra të ndryshme parandalimi. Por

Rëndësia e terapisë fizike

Çdo ditë e më tepër ne përballemi me problemet dhe shqetësimet e personave me aftësi të kufizuara fizike e mendore dhe jo vetëm kaq, por edhe me vështirësitë që hasin familjarët për t'u kujdesur për ta, që nga ana ekonomike e deri tek ajo fizike e psikologjike.



Fizioterapja si degë edhe pse ka disa vite që operon në Shqipëri, shumë pak njerëz janë të informuar për rezultatet e saj dhe shumë pak njerëz e kuptojnë rëndësinë e kësaj terapie në trajtimin e problemit të fëmijës apo të afërmit të vet.

Gjithashtu edhe mjekët në Shqipëri vitet e fundit kanë filluar t'u rekomandojnë pacientëve këtë shërbim. Fizioterapia nënkupton terapi fizike ku përfshihen lëvizjet e çdo hapësire artikulare, por edhe seanca terapeutike masazhi dhe masazh relaksues.

Këtë profesion të cilin e bëj më shumë dashuri më ka mësuar shumë, më ka mësuar të kuptoj pëveç vështirësisë fizike e mendore të tyre, të kuptoj zemrën, botën e tyre.

Për të gjithë ju njerëz që do të lexoni këtë shkrim, ju lutem hapni zemrat tuaja dhe jini të vëmendshëm ndaj asaj që fëmijët me nevoja të

veçanta ju thonë:

Unë jam fëmija që nuk flet. Ndonjëherë ti ndjen mëshirë për mua, unë e shikoj atë në sytë e tu edhe pse ti nuk ma thua. Unë jam fëmija që nuk mund të shikojë. Ndonjëherë ti nuk më shikon. Edhe pse unë nuk shikoj, e ndiej këtë gjë!

Ti do të pyesësh se si arrij ta kuptoj unë? Edhe pse nuk flas apo nuk shikoj, unë kuptoj çdo gjë, arrij të kuptoj kur ti je i gëzuar apo i trishtuar, kur ti je i duruar me mua apo jo.

Unë bashkohem me zemërimin tënd dhe irritimin tënd, duke ditur që imi është edhe më i madh por në ndryshim nga ti, unë nuk mund ta shpreh atë.

Unë jam fëmija që nuk mund të ecë dhe ti shikon engjëllin në sytë e mi, i cili del nga kjo karrocë me rrota dhe vrapon e luan si fëmijët e tjerë. Shumë herë njerëzit bëjnë sikur nuk më shikojnë, por unë gjithmonë i shikoj ata. Unë jam fëmija me dobësi mendore, nuk mësoj dot me lehtësi, unë ndiej një gëzim të pafund, kur mund të bëj diçka edhe pse për ty mund të jetë e vogël.

Unë jam fëmija që nuk flet, nuk dëgjon, nuk shikon, fëmija që nuk ecën, por unë jam mësuesi

gome, maska mbrojtëse, të bëjë larje urgjente e pikave të gjakut që mund të bjenë në lëkurë.

10) Imunizimi i fëmijëve me HIV, bërja e vaksinave kundër fruthit, rubeolës, parotid, hepatitet, TBC, poliomeelit

Si mjekohen Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme?

• Mos u përpini të vetë mjekoheni. Disa infeksione seksualisht të transmetueshme janë rezistente ndaj mjekimit dhe nuk shërohen plotësisht. Infeksioni mund të rrijë i fshehur duke u përsëritur herë pas here.

• Ndiq gjithmonë këshillat e mjekut dhe çoje mjekimin deri në fund edhe pse mund të mos kesh shenja dhe ndiheni mirë. Shko për një rikontroll tek mjeku mbas mbarimit të mjekimit. Një analizë tjetër është e nevojshme për t'u siguruar që jeni shëruar plotësisht .

Ku duhet të drejtohem për të bërë një analizë për Infeksion Seksualisht të Transmetueshëm?

• Ju mund të shkoni tek mjeku, dhe ai do t'ju thotë se çfarë do të bëni. Megjithatë, vendet ku ju mund të kryeni analiza janë:

• Laborator te mikrobiologjik në Drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethe, Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë

• Laboratorin mikrobiologjik në Qendrën Spitalore Universitare, "NënëTereza" Tiranë,

• Qendrat e Këshillimit e Testimit Vullnetar pranë DSHP-ve, në 12 qarqet e vendit.

Punoi: Valbona Seitlli

yt sepse të jap mundësi të kuptosh thellësinë e karakterit tënd, të dashurisë mirëkuptimit tënd, të jap mundësinë të kuptosh fatin tënd të madh siç janë:

-Këmbët e tua!

-Mundësinë tënde për të komunikuar me të tjerët!

-Aftësinë tënde për të bërë çdo gjë vetë!

-Të kuptosh që ke dhuratën më të madhe që mund të ekzistojë LIRINË, lirinë për të shijuar çdo gjë që dëshiron të shijojë një fëmijë.

Problemet tona janë të shumta dhe të ndryshme. Luftrat tona janë të vështira. Kështu që unë nga ju do të doja mirëkuptim dhe jo mëshirë, do të doja të më trajtoje njëllor si trajton personat e ashtuquajtur "normalë". Nuk do të doja të më lije jashtë botës tënde, sepse ajo është bota ime, sepse edhe unë si fëmijë kam të drejtat e mia. Kështu që të kërkoj të mos më injorosh, të lutem të më dëgjosh, kërkoj të më respektosh, dhe shpresoj të mos më harrosh.

Kjo histori është bota e një prej fëmijëve me nevoja të veçanta, që ne hasim çdo ditë në punën tonë si fizioterapistë.

Dhe kjo zemër thërret për ndihmë.

Ju faleminderit të gjithëve ju që do shfletoni këtë informacion, dhe ju lutem bëni edhe ju pjesën tuaj për të mbështetur këta njerëz!

Gentiana Rapçe

Fizioterapiste

Email: gena.rapce@yahoo.com

Planifikimi i Karrierës

Vjen një ditë që rritemi dhe kemi përgjegjësinë për të planifikuar dhe paracaktuar fatin tonë. Vjen një moment kur kemi në dorë timonin e jetës tonë dhe duhet të mendohemi mirë nga ta kthejmë atë për të mos ndjekur rrugën më të gabuar, por as për të ndjekur rrugën e mirë, por ç'është më e rëndësishmja, për të ndjekur rrugën më të mirë për ne e cila na pëlqen më shumë se të tjerat. Vjen një moment që vihemi përballë planifikimit të karrierës tonë. "Nëse ju nuk e dini se ku ju doni të shkoni, asnjë rrugë nuk ju çon ju atje". Ky është pikërisht planifikimi i karrierës.

Planifikimi individual i karrierës-vetëvlerësimi

Përmes planifikimit të karrierës një person në mënyrë të vazhdueshme vlerëson aftësitë dhe interesat e veta, konsideron mundësitë alternative të karrierës, vendos qëllimet e karrierës dhe planifikon aktivitetet e zhvillimit praktik. Planifikimi individual i karrierës duhet të fillojë me vetëkuptimin ose vetëvlerësimin. Atëherë personi është në pozicionin të vendosë qëllime realiste dhe të përcaktojë çfarë të bëjë për të arritur këto qëllime. Ky veprim gjithashtu i bën të njohur atij nëse qëllimet e tija janë vërtet realiste.

VETËVLERËSIMI është procesi i të mësuarit përreth vetëvetes. Çdo gjë që mund të ndikojë performancën e punës së një personi në të ardhmen duhet konsideruar. Vetëvlerësimi realist

do të ndihmojë një person të mënjanë gabimet që mund të ndikojnë të tërë përparimin e karrierës. Shpesh një individ e pranon një punë pa menduar fare nëse ajo përputhet me interesat dhe aftësitë e tij. Kjo shpesh çon në dështim. Kur një individ i duhet të përdorë në mënyrë frekvente aftësi që nuk ka kënaqësi t'i përdorë çojnë në moskënaqësi dhe burnout. Për shumë njerëz, pushimi nga puna i bën ata të ndalen dhe të analizojnë veten për të parën herë duke analizuar anët e forta dhe të dobëta. Disa teknika të mira të vetëvlerësimit përfshijnë bilancin e anëve të forta dhe të dobëta si dhe vrojtimin e pëlqimeve dhe mospëlqimeve.

DISA KËSHILLA:

- Asnjëherë mos ndalo së mësuarit! Të mësuarit gjatë gjithë jetës është çelësi kyç i suksesit në karrierën tënde. Nëse mendon se aftësitë e tua aktuale janë të mjaftueshme, ti ke vendosur gjithashtu se puna që ke aktualisht është mjaftueshëm mirë. Por nëse kërkon të bësh një karrierë në të ardhmen, duhet të shtosh dhe përmirësosh aftësitë dhe njohuritë e tua vazhdimisht. Bota është në ndryshim të vazhdueshëm dhe secili prej nesh kërkon mënyra të reja për të bërë biznes.

- Pyet, Dëgjo dhe Mëso! Një dëgjues i mirë mund të mësojë shumë.

Dëgjoje shefin, supervizorin dhe bashkëpunëtorët tuaj. Mund të mësosh shumë nga eksperiencia e tyre.

Pyet vazhdimisht për çështje që të interesojnë dhe dëgjo çfarë ata thonë. Lejo që ata të të thonë se si bëhen gjërat dhe si mund t'i kishit bërë më mirë.

- Krijë rrjetin tënd të kontakteve. Hapi tjetër për të ndërtuar një karrierë është përmes kontakteve që ke. A e di se më shumë se 50% e pozicioneve të punës sigurohen nga rrjeti i kontakteve? Nëse ke një rrjet të mirë kontaktesh, është gjithmonë një mundësi shumë e mirë për të zbuluar karrierën tënde si dhe për të eksploruar mundësi të reja. Kalo pak kohë duke krijuar kontakte dhe mos harro të mbash ato që ke.

- Përcakto punën që ke aktualisht. Puna që ke duhet të identifikohet dhe jo të supozohet. Sigurohu që të mos shpenzosh kohë duke kryer detyra që ti supozon se janë të rëndësishme. Ky është një harxhim i kohës dhe talentit tënd. Kur fillon një punë të re, fol me supervizorin tënd për prioritetet e tua. Nëse nuk je i sigurt për atë që është më e rëndësishme, atëherë pyet supervizorin. Shpesh do jeni të habitur për diferencat midis atyre që ti mendoje se ishin të rëndësishme dhe atyre që janë realisht më të rëndësishmet.

- Përcaktoni punën tuaj të ardhshme. Puna e ëndrrave të tua duhet të përcaktohet qartë. Përpara se të planifikosh një karrierë, sigurohu që të kesh përcaktuar punën që ke ëndërruar. Në punën që ke ëndërruar, ti gjithmonë bën atë që të pëlqen më shumë dhe asgjë që ty nuk të pëlqen. Cila është ajo punë? Të pëlqen apo nuk të pëlqen të kesh përgjegjësi mbi punonjësit e tjerë? Të pëlqen të punosh me teknologjinë apo me njerëz? Të pëlqen të kesh biznesin tënd? Të pëlqen të jesh një këngëtar apo një inxhinierë? Apo një menaxher? Përpara se të ndërtoni karrierën tuaj duhet të përcaktoni qartë qëllimin tuaj!



- Përgatitu! Puna që gjithmonë ke ëndërruar mund të shfaqet edhe nesër. Prandaj duhet të jesh gjithmonë i/e përgatitur! Mos prit asnjë sekondë. Rishiko CV tënde dhe vazhdimisht shtoj eksperiencia apo kualifikime. Nesër mund të të shfaqet puna që gjithmonë ke dashur, prandaj është e rëndësishme të jeni gati të përshkruani veten tuaj si më i/e përshtatshëm për pozicionin e punës.

- Zgjidh mjetet e duhura! Zgjidh mjetet të cilat mund t'i përballosh. Mund të ndërtosh një karrierë duke përdorur mjete të ndryshme. Mund të bëni kurse afat-shkurtër profesionale apo të bëni një master. Mos harroni: puna ku jeni aktualisht është një mjet shumë i mirë për të zhvilluar aftësi të reja.

- Realizo ëndrrën tënde! Është momenti për të bërë ëndrrat realitet! Mos lejo që një punë shumë e ngarkuar të shkatërrojë ëndrrat e tua. Nëse ke qëllime më të larta, fillo të veprësh. Nëse ke në plan për t'u arsimuar më shumë, të kesh një punë më të mirë, të fillosh biznesin tënd, mos lejo që puna që ke t'ju marrë të gjitha energjitë. Por këto energji përdori për të realizuar ëndrrën tënde!

Punoi: Evisa Biba



Intervista

Intervistë me Z. Leonard Berberi, Drejtori Ekzekutiv i Fondacionit Diakonia Albania, anëtar i Këshillit Bashkiak Pogradec (2011-2015)

Kohët e fundit kemi dëgjuar rreth një fondacioni të ri në qytetin tonë, me emrin Diakonia Albania. Mund të na thoni ju lutem, kush është Diakonia dhe kur është themeluar?

Në fakt Fondacioni Diakonia Albania ka filluar aktivitetin e tij në vitin 1992 me transporte humanitare, materiale shkollore për shkollat e Pogradecit, dhe transportin e dytë në vitin 1994 për fshatrat e thella malore Jollë, Shpellë, Zgallë, Bishnicë në komunën e Velçanit. Prej vitit 1997-2012 ka filluar aktivitetin e tij të plotë duke u stacionuar në fshatin Bishnicë, por duke punuar si një organizatë partnere e Fondacionit NEHEMIA. Prej Shkurtit të vitit 2012 bordi i shoqatës CHW.e.V Gjermani vendosi të regjistrojë si një organizatë më vete Fondacionin Diakonia Albania ose shkurt DA.

Lidhur me Fondacionin DA, një ndër aktivitetet që keni pasur në qytet ka qenë ekspozita "TASO dhe fëmijët e Mokrës" e lidhur kjo me Tetorin Gjerman. Ku qëndron ideja e këtij aktiviteti?

Tetori Gjerman është një eveniment i cili organizohet prej 8 – vitesh në Shqipëri. Ai përmban një sërë eventesh të larmishme të cilat ndodhin brenda muajit Tetor në të gjithë Shqipërinë, mbështetur nga Ambasada e Republikës Federale Gjermane në Shqipëri.

Ambasadori Gjerman, Z. Helmut Hoffmann u shpreh se "Ideja qëndrore e Tetorit Gjerman është të bashkojë njerëzit dhe të krijojë rrjete lidhjesh mes tyre. Ftojme shqiptarë dhe gjermanë të njohin më mirë njëri-tjetrin dhe të shndërrojnë Tetorin Gjerman të këtij viti, në një festë krejt të veçantë të miqësisë gjermano-shqiptare."

Pas më shumë se 25 vitesh nga momenti i lidhjes së marrëdhënieve diplomatike mes Gjermanisë dhe Shqipërisë, partneriteti ndërmjet këtyre dy vendeve, është strategjik, jo vetëm për aspiratën e Shqipërisë në Bashkimin Europian, por edhe për të pasuruar aspekte të ndërsjellta kulturore, artistike dhe historike të qytetarëve shqiptarë dhe gjermanë.

Fondacioni DA në këtë kuadër ka organizuar një ekspozitë me vizatime të 10 fëmijëve nga zona e Mokrës, pjesë e një projekti social nga Qendra Rezidenciale e fshatit Bishnicë, dhe Piktorit të madh të qytetit të Pogradecit Z. Anastas Konstandini i cili ka sjellë

një seri pikturash nga Gjermania, qyteti Wismar. Gjithashtu pjesë e këtij eventi ishte dhe prezantimi i punës 20 vjeçare të CHW.e.V dhe projekteve të organizuara nga DA, e prezantuar kjo në 10 rolaps me foto dhe shpejgime të projekteve në 3 gjuhë, Shqip, Anglisht dhe Gjermanisht.

Keni përmendur disa herë krahinën e Mokrës. Konkretisht, ku është e lokalizuar puna e fondacionit tuaj?

Puna jonë është lokalizuar në zonën e Mokrës së Poshtme, komuna Velçan, por aktivitetet tona shtrihen edhe në Mokrën e sipërme Komuna Trebinjë, qytetin e Pogradecit, Dushk të Lushnjës si dhe së fundmi në Tiranë.

Thatë se keni disa vite që punoni për këtë fondacion, shikoj tek ju se keni gjetur veten në këtë punë? Sa e vërtetë është kjo?

Prej vitit 2009 unë punoj për Fondacionin DA, pasi vizioni dhe misioni që mbart përfaqëson plotësisht qëllimin dhe dëshirën time të hershme për të kontribuar në ngritjen dhe zhvillimin e zonave të varfëra rurale. Pikërisht këtu kam gjetur vendin ku duhet punuar shumë, duhet punuar me zemër dhe dashuri për t' u ardhur në ndihmë atyre të cilët pothuajse janë harruar nga shteti.

Cilat janë projektet dhe target grupet me të cilat punon DA?

Projektet e Fondacionit janë: Puna Sociale, Zhvillimi i Arsimit, Mjedisit dhe Zhvillimit Agrar, Ndihma Humanitare, Puna me Bashkësitë, si dhe Zhvillimi i Bashkive dhe Komunave. Target grupet me të cilat ne punojmë janë: grupet vulnerabël për të tre grupmoshat, fëmijët, të rinjtë dhe të moshuarit, familjet e varfëra ose ekstrem të varfëra, bashkitë dhe komunat në zhvillim.

Sa është Bishnica e lidhur me projektet tuaja sociale?

Bishnica është fshati ku ne kemi Qendrën Rezidenciale për projektin e Arsimit të fëmijëve. Aktualisht qendra jonë, iu vjen në ndihmë 25 fëmijëve nga fshatrat Zgallë, Jollë, Shpellë dhe Bishnicë. Fëmijët vinë nga familje të varfra dhe ekstremisht të varfra. Ne i mbështesim në qendër duke ofruar për ta shërbim 24 orë falas.

Klinika e fizioterapisë dhe ndihmës mjekësore në shërbim të 35-së klientëve për njerëzit me aftësi të kufizuar fizike, familje në



nevojë, dhe ndaj të moshuarve qofshin ata të vetmuar dhe në nevojë. Gjithashtu disponojmë edhe Qendrën Ditore në Buzaishtë, atje ofrojmë ushqim, shërbim mjekësor dhe social për njerëzit në nevojë dhe familjet e tyre.

Nardi, me aq sa unë ju njoh ju përgjithësisht bëni shumë shaka fine. Keni sot ndonjë "koment" për shoqatën "Unë, Gruaja"?

Qesh... po, është shumë e vërtetë. Shakaja është pjesë e jetës sime si edhe e shumë të tjerëve mendoj. Pas vendimit të parlamentit shqiptar për të vendosur pjesëmarrjen e gruas me 50% në nivelin e përfaqësimit në këshillat bashkiakë i ka ardhur fundi misionit "Unë, Gruaja" dhe duhet hapur një shoqatë "Unë, Burri" që të mos humbasin dhe atë 50% që u ka mbetur.

Ju faleminderit për kohën dhe përgjigjet tuaja!

Intervistoi: Msc. Manjola Lushka

Të rinjtë pjesëmarrës

Trajner: Ermald Meko

1. Manjola Lushka (kryeredaktore)
2. Vasilika Hidri
3. Gentiana Rapçe
4. Julian Halili
5. Johannes Kalb
6. Ozvelta Laze
7. Eduart Hyka
8. Anxhela Mukollari
9. Evisa Biba
10. Geralda Alillari
11. Valbona Seitlli

Projekti: *Më shumë të rinj në leadership nëpërmjet pjesëmarrjes qytetare.*

Ky projekt mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë. Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë material nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.